



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. _____ Prot

Datë 23/09/2024

PROCES VERBAL

Konsultimi mbi Ngritjen e Stacionit të Trajtimit të Mbetjeve të Riciklueshme

Vendi : Salla e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

Ora : 13:00

Tema e konsultimit : Ngritja e Stacionit të Trajtimit të Mbetjeve të Riciklueshme

I mbajtur sot më datë 23 Shtator 2024 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Përmet. Të pranishëm në këtë takim janë : Kryetarja e Bashkisë Përmet znj. Alma Hoxha, n/Kryetari i Bashkisë Përmet z. Florand Hasani, përfaqësuesi i GIZ z. Artur Galanxhi, punonjës të administratës së Bashkisë Përmet, përfaqësues të bizneseve të ndryshme, banorë të zonës ku është planifikuar të ndërtohet stacioni, dhe qytetarë të tjerë të interesuar.

Takimi u hap nga **znj. Alma Hoxha** e cila fillimisht përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Më pas ajo filloi të prezantoi shkurtimisht projektin e ri duke treguar mënyrën si do të funksionojë ky stacion dhe rëndësinë që ka ai për gjithë banorët e zonës. Gjithashtu u tregoi të pranishmëve se ky projekt ka për qëllim të ndajë mbetjet sipas llojeve përkatëse. Kjo qëndër do të ndërtohet në lagjen SMT, pranë zyrave të Rruga-Ura. Më tej **znj. Hoxha** ja la fjalën ekspertit të GIZ për të sqaruar më mirë dhe më qartë çdo detaj të këtij projekti.

Fjalën e mori **z. Artur Galanxhi** përfaqësues i GIZ i cili prezantoi edhe një herë këtë projekt për ndërtimin e një stacioni të mbetjeve. Ky projekt është realizuar me mbështetjen e Bashkisë Përmet të cilën e falenderoi për angazhimin dhe përkushtimin e treguar në realizimin e fazave fillestare të këtij projekti.

Ai vijoi duke u treguar se qëllimi kryesor i këtij projekti është mbrojtja e mjedisit dhe ndarja e mbetjeve sipas llojit të tyre, si edhe nxjerja e të ardhurave nga shitja e mbetjeve të ricikluara. Sigurisht realizimi i këtij projekti është një sfidë për të gjithë aktorët pjesëmarrës. Për të arritur në rezultate të kënaqshme duhet një ndërgjegjësim i lartë nga ana e banorëve të Përmetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Më pas **z.Galanxhi** u tha se shumë shpejt do të fillojë vendosja e koshave të dedikuara në disa pika të qytetit dhe në njësitë Piskovë dhe Petran. Këta kosha do të jenë të dedikuara për llojet e ndryshme të mbetjeve si plastika dhe kartoni. Pasi të grumbullohen nga një mjet i posaçëm ato do të transportohen drejt stacionit ku do të përpunohen dhe më pas do të nisen të përpunuara drejt vendgrumbullimit në Bajkaj. Me anë të këtij projekti do të mbrohet mjedisi si dhe do të rritet punësimi.

Gjithashtu ai tha se kjo qëndër është investim i GIZ dhe blerja e makinerive dhe mjeteve të nevojshme do të bëhet e mundur nga ana e tyre. Ky stacion ka një sipërfaqe prej 120m² dhe një lartësi prej 6m.

Pasi përfundoi fjalën e tij, ai u la hapësirë të pranishmëve për të shprehur opinionet e tyre dhe të pyesin për çdo lloj paqartësie që ata mund të kenë lidhur me këtë projekt.

- **Pyetjet e bëra :**

A është e mundur që në një prej fasonerive të shkojë mjete i GIZ për të marrë mbetjet ? (Përfaqësuesi i një prej fasonerive)

- **Do të shikohet mundësia që mjete të shkojë drejt në fasoneri.**

Ku do të vendosen koshat e dedikuara ? (Një pronar i një barkafe)

- **Koshat do të vendosen në rruget kryesore të qytetit dhe pranë supermarketeve e restoranteve, më pas do të shikohet mundësia për të vendosur në gjithë qytetin.**

Si janë koshat ? (Një pronar i një hoteli)

- **Koshat janë metalik transparent, dhe të specifikuar për llojet e ndryshme të mbetjeve**

A përbën shqetësim për banorët e lagjes kjo qëndër ? (Banori i zonës)

- **Jo, i gjithë procesi kryhet në një ambient të mbyllur dhe nuk ka asnjë shqetësim pasi është një proces i pastër dhe mjaft i sigurtë.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Pasi dëgjoi dhe pyetjet e bëra nga të pranishmit, z.Galanxhi i falenderoi dhe një herë të pranishmit si dhe i ftoi ata të jenë pjesë e diskutimeve të ardhshme lidhur me këtë çështje të rëndësishme për qytetin e Përmetit.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:

